

# BULETINI JAVOR

## 26-30 NËNTOR 2023



Shprehja

"Vendimi që marrim për sigurinë sot do të përcaktojë llojin e shoqërisë në të cilën jetojmë nesër."

e javës

Përmbajtja:

- Siguria Kibernetike në Sektorin e Transportit

## Siguria Kibernetike në Sektorin e Transportit

Sektori i transportit mbetet veçanërisht i prekshëm ndaj kërcënimeve të sigurisë kibernetike për shkak të varësisë së tij nga teknologjia. Semaforët, kullat e kontrollit të trafikut ajror varen nga teknologjia për të funksionuar në mënyrë të sigurt dhe efektive.

Disa nga llojet më të zakonshme të sulmeve kibernetike që mund të synojnë sektorin e transportit përfshijnë sulme malware, sulme ransomware, sulme të mohimit të shërbimit dhe sulme phishing.

### Këshilla sigurie

Kufizoni aksesin në sistemet tuaja



**UPDATE**


Kryeni gjithmonë përditësimet e nevojshme

Trajnioni të gjithë stafin tuaj



Aplikoni praktikat më të mira të sigurisë kibernetike

Përgatitni një plan për reagimin ndaj incidentit



# BULETINI JAVOR

## 26-30 NËNTOR 2023



Shprehja

"Vendimi që marrim për sigurinë sot do të përcaktojë llojin e shoqërisë në të cilën jetojmë nesër."

e javës

Përmbajtja:

- Mbi 20,000 serverë të cënueshëm të Microsoft Exchange të ekspozuar ndaj sulmeve
- Dollar Tree-data breach
- Apple përditëson në mënyrë urgjente dy vulnerabilitete të tipit zero-day
- Google-patching alert



### Mbi 20,000 serverë të cënueshëm të Microsoft Exchange të ekspozuar ndaj sulmeve

Dhjetëra mijëra serverë emaili të Microsoft Exchange në Europë, SHBA dhe Azi janë të cënueshëm ndaj ekzekutimit të kodit në distancë.

Sistemet e emaileve ekzekutojnë një version software-i që aktualisht nuk ka asnjë lloj përditësimi, duke qenë të cënueshëm ndaj problemeve të shumta të sigurisë, disa prej të cilave vlerësohen si kritike.

[Lexo më shumë](#)



### Dollar Tree -data breach

Dollar Tree së fundmi u ndikua nga një shkelje e të dhënave nga palët e treta që preku 1,977,486 njerëz pas hakërimit të ofruesit të shërbimit Zeroed-In Technologies.

Aktorët e kërcënimit arritën të vidhnin të dhëna që përmbanin informacione personale të punonjësve të Dollar Tree dhe Family Dollar. Informacioni i vjedhur gjatë sulmit përfshin emrat, datat e lindjes dhe numrat e sigurimeve shoqërore (SSN).

[Link: Lexo më shumë](#)

## PATCHING ALERT



### Google-patching alert

Google ka publikuar përditësimet e sigurisë për shtatë probleme sigurie në shfletuesin e saj Chrome, duke përfshirë një vulnerabilitet të tipit zero-day që është nën shfrytëzim aktiv.

Përdoruesve u rekomandohet të përmirësojnë versionin 119.0.6045.199/200 të Chrome për Windows dhe 119.0.6045.199 për macOS dhe Linux për të zbutur kërcënimet e mundshme.

[Link: Lexo më shumë](#)



### Apple përditëson në mënyrë urgjente dy vulnerabilitete të tipit zero-day

Apple publikoi përditësimet urgjente të sigurisë për të rregulluar dy vulnerabilitete të shfrytëzuara në sulme që preknin pajisjet iPhone, iPad dhe Mac.

Kompania thotë se adresoi të metat e sigurisë për pajisjet që përdorin iOS 17.1.2, iPadOS 17.1.2, macOS Sonoma 14.1.2 dhe Safari 17.1.2

[Link: Lexo më shumë](#)